



Pranuar / Dorezuar Punë/Pradato Received/Delivery	04-05	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMESHCK	25810/2022		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.274/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.274/2022 të datës 23.03.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 04.05.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.274/2022 e datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesi _____
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër Nr.7446 i datës 14.03.2022, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën II të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ është i punësuar në Komunën e Kamenicës, sipas akt emërimit me numër Nr.18708 të datës 28.08.2020 në pozitën Inspektor i komunikacionit në Departamentin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambient dhe Inspektorat.

Me datën 14.03.2022, Kryetari i Komunës së Kamenicës, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.7446 sipas të cilit ankuesin e autorizon që përkohësisht ti kryej punët dhe detyrat e inspektorit të komunikacionit të ndërtimit duke filluar nga data 15.03.2022, me arsyetimin se nëpunësi i cili ka mbajtur këtë pozitë gjendet në pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin Nr.7446 të datës 14.03.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, lidhur me angazhimin e përkohshëm të kryerjes së detyrave si inspektor i ndërtimit, me datën 23.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1544/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se i njëjti nuk e posedon kualifikimin adekuat lidhur me kryerjen e punëve si inspektor i ndërtimit, i njëjti pretendon se ky vendim nuk thekson përdhën kohore të vlefshmërisë së këtij vendimi lidhur me kryerjen e punëve nga pozita e lartcekur, i njëjti poashtu thekson se për çështjen e njëjtë ka parashtruar edhe ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Kamenicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.04.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1825/2022 për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa me datën 12.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1544/2022 të datës 23.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.7446 të datës 14.03.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Ankesën me numër Nr.8625 të datës 22.03.2022 e parashtruar nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Akt emërimit të ankuesit me numër Nr.18708 të datës 28.08.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 12.04.2022 nga Komuna e Kamenicës me provat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me numër Nr.13257 të datës 01.07.2020; Vendimin me numër Nr.4546 të datës 21.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Përgjigjen në kërkesë me numër 11283 të datës 12.04.2022 nga Komuna e Kamenicës; Provën shtesë nga ankuesi të datës 24.03.2022; Konkursin e datës 30.06.2020; Përgjigjen në ankesë të datës 26.04.2022 lidhur me provat shtesë për lenden e ankuesit nga Komuna e Kamenicës; Diplomën e ankuesit me numër 239 të datës 31.08.2016; Diplomën e ankuesit me numër 161 të datës 01.03.2010; përrshkrimin e detyrave të punës; Kërkesën e datës 26.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me provat shtesë për lëndën e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të provave të lëndës si dhe ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se bazuar në përrshkrimin e detyrave të punës së ankuesit si dhe duke i'u referuar edhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pozita "Inspektor i komunikacionit" në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pranë Komunës së Kamenicës të cilën e mban ankuesi hyn në grupin e pozitave,"40.Gr, "Specialistë të Inxhinierisë së Telekomunikacionit, ku përgatitja profesionale e arsimit kërkohet: "Inxhinieri të telekomunikacionit", ndërsa në pozitën si "Inspektor i ndërtimit" të cilën ankuesi është sistemuar përkohësisht dhe është caktuar ti kryej punët dhe detyrat nga kjo pozitë, hyn në grupin e pozitave,35.Gr, "Specialistë i inxhinierisë së ndërtimit", ku përgatitja profesionale e arsimit kërkohet: "Inxhinieri ndërtimi", e që në bazë të provave të lëndës të bashkangjitur nga organi i punësimit, ankuesi posedon diplomën Bachelor i Inxhinierisë Mekanike -Drejtimi Komunikacionit si dhe diplomën e

studimeve Master i Shkencave të Inxhinierisë Mekanike, ndërsa për pozitën "Inspektor i ndërtimit" në të cilën është autorizuar ankuesi lidhur me kryerjen e punëve dhe detyrave, nëpunësi duhet të jetë me kualifikim nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit dhe realisht duhet të përmbaj edhe diplomën nga kjo fushë sipas rregullores së lartcekur.

Bazuar në këtë fakt, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përgatitja profesionale e ankuesit nuk është e përshtatshme me përgatitjen respektivisht përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën është caktuar përkohësisht, kështu që duke iu referuar edhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konkretisht shtojcës nr.2 lidhur me Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, Kolegji vlerëson se për rastin konkret të ankuesit nuk është bërë analizë e saktë e plotësimit të kushteve lidhur me sistemimin e ankuesit dhe autorizimin e kryerjes dhe detyrave edhe për një pozitë tjetër për ankuesin, ngase ankuesi në të njëjtën kohe detyrohet të mbaj dy pozita të punës me orar të plotë të punës e që është pa mbështetje ligjore, andaj në këtë kontekst Kolegji vlerëson se Vendimi i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, me numër të protokollit 7446 të datës 14.03.2022, për sistemimin e ankuesit për kryerjen e detyrave për pozitën si inspektor i ndërtimit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen e transferit të përkohshëm për interes të institucionit, përkundër që në vendim të kryetarit të komunës nuk është specifikuar asnjë elementë se mbi bazë të cilit kriter apo bazë ligjore është ngarkuar ankuesi që në të njëjtën kohë ti mbajë dy vende të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me këtë rast, ka vlerësuar se institucioni i Komunës së Kamenicës, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve pas situatës së krijuar që nga momenti kur nëpunësit civil i është lejuar pushimi pa pagesë, është dashur të veprojnë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe të emërojnë nëpunësin kompetent që i përket fushës së kërkuar lidhur me pozitën konkrete, andaj edhe sistemimi i ankuesit lidhur me kryerjen e detyrave dhe punëve përkohësisht për në pozitën si "Inspektor i ndërtimit", është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik, pasi që i njëjti nuk posedon kualifikimin adekuat që kërkohet në lidhje me pozitën të cilën është autorizuar përkohësisht dhe nuk mund të kryej punët dhe detyrat të një fushe krejt tjetër profesionale, ndërsa se ankuesi nuk i plotëson kriteret për këtë pozitë është konfirmuar edhe nga vetë shkresa e organit të punësimit të datës 12/04/2022, dërguar këshillit përmes përgjigjes në kërkesë si dhe në bazë të konkursit të shpallur për pozitë të Inspektorit të Komunikacionit të datës 30/06/2020.

Kolegji konstaton se përveç asaj që u specifikue më lartë dhe nëse analizohet Vendimi i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, me numër të protokollit 7446 të datës 14.03.2022, për sistemimin e përkohshëm të ankuesit, që në bazë të pretendimit të ankuesit si dhe vendimit të atakuar nënkuptohet se ka të bëjë me transferim të përkohshëm për kryerjen e detyrave në pozitën si inspektor i ndërtimit, ndërsa nëse kemi parasysh preambulën e këtij vendimi ku përcaktohet baza ligjore e nxjerrjes së të njëjtit, mund të nxjerrët konkludimi se nuk është i bazuar në asnjë dispozitë të Ligjit të Zyrtarëve Publik Nr. 06/L - 114, i cili ligj përmes nenit 52 rregullon në mënyrë të hollësishme këtë çështje dhe at si më poshtë: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për atë që është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës", ndërsa nga përmbajtja e vendimit me numër të protokollit 7446 të datës

14.03.2022 përveç mungesës së bazës ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimit nuk plotësohen asnjë nga këto elemente të transferimit të përkohshëm të potencuara më lartë dhe kur kihet parasysh fakti se përmes këtij vendimi nuk është përcaktuar baza ligjore e përcaktuar në ligjin e zyrtarëve publik, periudha e saktë e ushtrimit të detyrës së përkohshme, forma dhe mënyra e obligimit të ankuesit që të ushtrojë edhe një pozitë tjetër në të njëjtën kohë ,përgatitja profesionale jo adekuate, akti administrativ/vendimi i paqartë, kundërthënës dhe i pa kuptueshëm sa i përket të drejtës për të sistemuar në këtë formë, janë argumente të mjaftueshme për të konsideruar se pretendimi i ankuesit është i bazuar mbi bazën e këtyre elementeve.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.274/2022, datë 04.05.2022

Ardita Perçulaj-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës dhe
- ❖ Arkivat të KPMSHCK-së.

